



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtuesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numrin 12-763/1 datë 03.02.2020. HIDHET POSHT.

Kërkesa në fjalë me pretendime për funksionimin e një personi juridik në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Mjedisin jetësor, të dorëzohet në veprimin kompetent të Inspektoratit Shtetëror për Mjedisin jetësor.

Lënda me numër 12-763/1 datë 03.02.2020 të mbyllet dhe arkivohet.

Vendimi, në formë të depersonalizuar, të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më datë 03.02.2020 është dorëzuar një denoncim nga një parashtues i panjohur me pretendime për funksionimin e një personi juridik në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Mjedisin jetësor.

Në denoncim, parashtuesi thekson se fabrika e caktuar për prodhimin e p

eletit funksionon pa leje përdorimi, pa leje ndërtimi dhe pa leje mjedisore, gjë që krijon një ndotje të madhe mjedisore dhe zhurmë të madhe, që është në kundërshtim me dispozitat ligjore për mjedisin jetësor. Parashtuesi kërkon që KSHPK-ja të kontrollojë se me çfarë lloj dokumentacioni punon personi juridik dhe të hetojë motivimin e individëve drejtues përse nuk kanë marrë masa ligjore, duke keqpërdorur pozitën dhe autoritetin e tyre zyrtar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se ato i referohen veprimeve në kundërshtim me Ligjin për Mjedisin jetësor, për të cilat KSHPK-ja nuk ka kompetencë të veprojë. Meqenëse veprimet e denoncuar janë aktivitete për të cilat autoriteti për të vepruar në pajtim me nenin 194 paragrafi 2 të Ligjit për mjedisin jetësor ka një autoritet tjetër që është kompetent për të

vepruar në këtë fushë - Inspektorati Shtetëror për Mjedisin jetësor, KSHPK-ja ka konstatuar se kërkesa do t'i dorëzohet autoritetit kompetent për veprim.

Duke marrë parasysh sa më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**  
Nënkryetar  
Katica Nikolovska

përgatiti: J:C

miratoi: K.N, anëtar i KSHPK-së

